



KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE
Drejtoria e Subjekteve Zgjedhore, Mbikëqyrjes, Financimit dhe
Monitorimit

KRITERET DHE DOKUMENTACIONI I DUHUR

PËR TË APLIKUAR PËR EKSPERT KONTABËL TË LICENSUAR (AUDITUES LIGJOR)
PËR AUDITIMIN E VITIT KALENDARIK 2022

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve kërkon të kontraktojë ekspertë kontabël të licensuar (auditues ligjor) për auditimin e fondeve të përfituara dhe të shpenzuara nga partitë politike gjatë vitit kalendarik 2022.

Ekspertët kontabël të licensuar (audituesit ligjor), përveç kushteve të përgjithshme të ushtrimit të profesionit të përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duhet të plotësojnë njëkohësisht edhe kriteret e mëposhtme:

- a. Të ushtrojnë profesionin e ekspertit kontabël të licensuar (audituesit ligjor) për jo më pak se 5 (pesë) vitet e fundit;
- b. Të mos kenë marrë masa disiplinore në fuqi;
- c. Të mos jenë anëtar të ndonjë partie politike në 5 (pesë) vitet e fundit;
- d. Të mos kenë qenë kandidat të mbështetur nga ndonjë parti politike, koalicion apo kandidat i propozuar nga zgjedhësit në 2 (dy) zgjedhjet e fundit;
- e. Prindërit, bashkëshorti/ja, bashkëjetuesi/ja dhe fëmijët madhor të mos jenë anëtar të partisë politike objekt i auditimit.

Aplikantët duhet të dorëzojnë brenda datës 6.4.2023 në mënyrë elektronike në email-in Enxhi.Podgorica@kqz.gov.al ose fizikisht pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dokumentat si më poshtë vijon:

- a. Kopje të noterizuar të licencës të ekspertit kontabël të licensuar (auditues ligjor), lëshuar nga IEKA, e vlefshme për vitin kalendarik respektiv;
- b. Vërtetim nga IEKA që vërteton se eksperti kontabël i licensuar (audituesi ligjor) ka jo më pak se 5 (pesë) vite eksperiencë dhe se nuk ka masë disiplinore në fuqi;
- c. Fotokopje të dokumentit të identifikimit;
- d. Deklaratë vetjake se nuk është në kushtet e parashikuara në shkronjat “c” dhe “d” të sipërcituara, sipas formatit të miratuar në shtojcën 1 bashkëlidhur udhëzimit nr. 14, datë 9.6.2021, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, “Për caktimin e kriterëve, procedurat për përzgjedhjen dhe emërimin e ekspertëve kontabël të licensuar dhe kushtet kontraktuale për auditimin e fondeve të përfituara dhe të shpenzuara nga partitë politike gjatë viti kalendarik dhe subjektet zgjedhore dhe kandidatët e tyre në fushatën zgjedhore”;
- e. Raport mjeko-ligjor;
- f. Vërtetim të gjendjes civile

Pas përfundimit të periudhës së aplikimit, Komision i Posaçëm i ngritur me urdhër të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve realizon, brenda 5 (pesë) ditëve, verifikimin e plotësimit të kriterëve formale të sipërcituara. Brenda 3 (tre) ditëve nga miratimit i listës paraprake hidhet shorti për caktimin e ekspertëve kontabël të licensuar (audituesve ligjor).